

Dashuria nuk vret

Ana hapi portën e shtëpisë dhe pa në korridor një zarf, që postieri e kishte futur nga nëndera. “Ç’ të jetë kjo?”-tha dhe u ul e mori zarfin në dorë. Duke ecur drejt portmantosë për të varur çantën, lexoi adresën. E dërgonte te zja e saj, Ermioni, që banonte në një qytet industrial jo shumë larg qytetit të vogël ku banonte ajo.

Ana kishte dhe një teze tjetër, Figon, por teze Ermioni zinte një vend të veçantë në jetën e saj. Grua e qeshur dhe e dhembshur, e mençur e shpirtdete, me burrin e saj, Tomorrin dhe dy djemtë ishin bërë për Anën si derë babai.

Nëna i kishte vdekur shpejt, kur Ana sa kishte mbushur dymbëdhjetë vjeçe dhe babai, një burrë i qetë, saldator në një ndërmarrje prodhimi makinerish bujqësore, ishte martuar shpejt me një grua të divorcuar. Njerka dhe vajza që në fillim u duk që nuk ishin prerë për njëra-tjetrën sepse shumë shpejt filluan mosmarrëveshjet midis tyre, në fillim të vogla e pastaj duke u thelluar deri sa hapën një përrua të madh, i cili zor se mund të mbyllej. Ana e donte shumë babanë dhe gjithnjë me ose pa asnjë të drejtë, ajo ishte në krahun e tij. Them në krahun e tij pasi grindjet në shtëpi u bënë pothuaj të përditëshme, aq sa secilit më vete i dukej sikur kishte hyrë shejtani brenda dhe shërri nuk do të mbaronte kurrë.

Herë-herë, Ana vinte tek varri i nënës dhe qante me lot të nxehtë. Kur ngopej së qari e ndjente veten më të çliuar, por kjo nuk ndihmonte aspak për sheshimin e marrëdhënieve me njerken.

Njerka nuk kishte fëmijë dhe ndoshta ky ishte një shkak për nervozizmin e saj, por as Ana dhe babai nuk kishin faj për këtë. E vërteta është që babai mbeti në një mëdyshje të përhershme në marrëdhëniet njerke-vajzë dhe si për të ndryshuar diçka ndihmoi fati.

Pas ca kohësh, Anës i dhanë një bursë për mësuese në një shkollë pedagogjike, që ndodhej në qytetin ku ishte teze Ermioni.

Ditët që e ndanin nga fillimi i shkollës në familjen e tyre kaluan pak a shumë të qeta. Njerka dhe Ana e kuptonin ndarjen e afërt dhe për pasojë i bënin lëshime njëra-tjetrës. Babai e vuri re këtë marrëveshje të heshtur dhe sytë e tij shpesh herë mbusheshin me lot, por ndërkohë ndiente që ishte i pazoti për t’i dhënë rrjedhën e duhur gjithçkaje dhe u mjaftua me aq.

Edhe Ana e kuptonte pozicionin e babait, ndaj ruhej nga një sherr i mundur, që do ta lëndonte shumë atë, që ajo e adhuronte dhe që ishte i vetmi që i kishte mbetur në jetë.

Një ditë para se të largohej për në shkollë, Ana vajti te varri i nënës, i çoi lule të freskëta, hoqi disa fije bari, që kishin mbirë në anë të tij dhe derdhi lot më shumë se kurrë. Dikur puthi fotografinë e nënës dhe iu duk sikur po ndahej përfundimisht me të.

Buzëmbërëmbja e ngrohtë e fundgushtit dukej sikur po e ftonte të bënte një xhiro nga parku i vogël i qytetit, apo nga parku i rinisë, siç i thoshnin banorët. Mbrëmjeve, në verë, ai park mbushej me njerëz, por më shumë me të rinj e të reja, që bënin shaka e ngacmonin njëri-tjetrin me zë të lartë e të qeshura të forta.

Ajo nuk kishte qejf të takonte ndonjë shok a shoqe sepse donte ta kundronte qytetin në vetmin e saj. Ishte rritur në atë qytet, kishte kaluar fëmijërinë, kishte bredhur udhëve të gurta të tij, kishte qeshur e kishte qarë, kishte lënë eshtrat e nënës se dhembshur e tani po ikte për t’i mbajtur të gjalla si kujtime të bukura e të hidhura ato vite që kishin kaluar.

Për një çast iu kujtua babi dhe një gulç ngashërimi i zuri fytin. Ai e priste sonte të vinte shpejt në shtëpi sepse donte që të rrinte sa më shumë me të këtë natë. Ai do ta shoqëronte të nesërmen për në shkollë, por ideja e ndarjes ia shtonte më shumë shtrëngimin në gjoks. Ana e donte babanë dhe i vinte keq për të, ndaj mori udhën për në shtëpi dhe shpejtoi hapat.

Kur hapi derën dhe hyri në korridor, ndjeu erën e mishit të pjekur që vinte nga kuzhina.

“Diçka po ndodh”, -mendoi me vete dhe hyri në dhomë.

Babi iu afrua dhe e përqafoi fort. Nuk e pyeti ku ishte sepse ai e dinte mirë ç'vajtë kishte. E puthi në flokët e saj të gështenjtë, hoqi thellë në zemër dhe nuk mundi të fliste. Ana nuk e ngriti kokën sepse po ta shiltenë sy babanë do të shpërthente prapë në vaj, por ngriti dorën dhe e vuri për një çast te faqja tij dhe pastaj te buza. Ai e mori dorën e saj në dorën e tij të ashpër, e puthi fort dhe një pikë loti ra mbi të. E puthi prapë dhe mbështeti kokën e tij mbi flokët e saj. Këtë kënaqësi e prishi njerka, që hyri atë çast.

-Po hë, ju të dy, sikur do të ndaheni për jetë nga njëri-tjetri, -tha ajo me një zë çuditërisht të qetë.- Ja ku është qyteti tjetër.

Në një të njëqindën e sekondës nëpër trurin e Anës u filtruan këto fjalë. Për herë të parë ajo nuk gjeti ndonjë shenj ironie, smire a diçka tjetër dhe u habit.

Ato fjalë dhe ajo darkë, në kujtesën e Anës mbetën si një pasarelë e vogël mbi lumin e madh të ndarjes, e cila nuk u shkel kurrë sepse pak muaj më pas, Ana do humbiste babanë në një aksident automobilistik dhe njerka do të vazhdonte jetën për hesap kësaj. Kjo ishte dhe arsye që vajza u lidh fort me familjen e teze Ermionit.

-Ana, -vazhdoi njerka atë natë, -më ndihmo të shtrojmë tryezën!

Babai u ul në divan dhe ato të dyja kryen në heshtje ritin e të shtruarit të tryezës, pa e parë njëra-tjetrën në sy. Ana vuri re që asgjë nuk mungonte, deri tek ëmbëlsira.

Përsëri diçka i vetëtiti në tru.

“Mos është darka e fundit në shtëpinë tonë?-mendoi.

-Darka e përcjelljes, darka e ndarjes”, dhe gulçi i lotit ia zuri përsëri grykën.-Nuk e di, -tha, -por dhe në është ashtu, le të derdhet kjo kupë e gjithë, -dhe me dorën e djathtë ngriti flokët, që i kishin rënë mbi sy.

-Hajde gëzuar, -tha babai me gotën e verës në dorë.

-Të vesh mirë, moj bijë, të mësosh e të bëhesh e zonja e vetes tënde. E trokiti gotën me të dyja dhe e ktheu me fund.

-Avash, -i tha njerka.-Varë ka plot, por mos u nxito .Ana nuk është e para dhe është e zonja e vetes. Përsëri vetëtiti truri i Anës, përsëri filtroi dhe përsëri nuk dalloj gjë.

“Mos e kam trurin të lodhur?”-tha me vete.

Filluan të hanë në heshtje e duke e thyer qetësinë herë me ndonjë problem të lagjes e herë me ndonjë ngjarje të punës së babit e të njerkes.

Dikur njerka mori gotën dhe tha:

_Ana, gëzua!Dua të të them dy fjalë, por dua t'i marrësh ashtu siç t'i them. Dua të mësosh në shkollë, të bëhesh dikush, të nderosh veten dhe babanë tënd. Është njeri i mirë babai yt. Nëse ndonjëherë do më falësh për ç'ka ndodhur, unë do ta mirëpres fjalën tënde.

Ana hodhi sytë nga babai dhe ai i treti sytë e saj. Ngrit gotën, e pa njerken në sy dhe e trokiti me gotën e saj duke belbëzuar në “gëzuar!”

Të nesërmen e më pas, ngjarjet rrodhën shumë shpejt, ashtu si rrjedh jeta e të gjithë njerëzve në botë. Këto iu ripërsëritën Anës duke lexuar letrën, që i dërgonte teze Ermioni, e cila e ftonte në dasmën e djalit të saj të madh, Benit, që ishte fejuar me në vajzë të bukur nga Veriu edhe ajo mësuese, ndërsa ai inxhinier në një objekt të madh hidroenergjetik, që ishte ndërtuar në ato anë.

I donte shumë djemtë e tezes, Benin dhe Artanin. Ata ishin më të vegjël se ajo, por vitet e shkollës që jetoj në shtëpinë e tyre, i lidhën fort me njëri-tjetrin. Sepse kur vajti me babanë në konvikt e shkollës, teza nuk la gur pa lëvizur që ta hiqte andej dhe ta merrte në shtëpinë e saj. Megjithë rregullat e rrepta që kishin konviktet në atë kohë, ajo ia arriti qëllimit.

Ana jetoj në shtëpinë e tare deri sa mbaroi studimet dhe u emërua mësuese në një qytet diku larg nga verilindja e vendit.

Ndërsa hodhi vështrimin nga ora, Ana u ngrit të merrte djalin në kopsht. E la letrën mbi tavolinë, mori çantën dhe nxitoi. Djali priste në bërën e kopshtit duke luajtur me moshatarë të tjerë. E kishte djalin pesëvjeçar. Një fëmijë të ëmbël, i zgjuar e i shkathët. I ati i jepte shumë liri veprimi. Ai punonte agronom në fermë dhe kishte pak kohë të lirë. Atë pak kohë e harxhonte me djalin

deri sa e zinte gjumi dhe pastaj merrej me punët e tij. Ana gëzohej për këtë lidhje ose si e quante ajo duke qeshur "solidaritet mashkullor-familjar"

Sa e pa nënën, djali iu hodh në qafë, e puthi në faqe, e puthi dhe ajo, i dha dorën dhe ashtu, të dy bashkë u drejtuan për në shtëpi.

Letra në tavolinë i tërhoqi vëmendjen djalit.

-Ç'është ky zarf këtu, mami?-e pyeti.

-Harrova, kurban mami, -i tha ajo.-Do të vemi në dasmë te nëna Ermioni se do martohet Beni me Lidën. E njeh Lidën ti?

-E njoh, e njoh, -tha djali dhe filloi të kërcejë nëpër shtëpi.

-Sot do ikim, mami?-e pyeti djali.

-Jo, shpirti i mamit, pas disa ditësh, -i tha ajo.

Edhe vetë sepse ndiente një gëzim të brendshëm që do të takohej me ata njerëz. Hyri në kuzhinë, hodhi gjellën në pjata dhe, pasi hëngrën drekë të dy, ndërsa djalin e për gjumë, vetë filloi të përgatitej për të nesërmen se do të shkonte në shkollë.

Bujari, i shoqi, si zakonisht erdhi vonë në darkë. Sa hapi derën djali iu hodh në krahë. Ashtu hynë të dy në dhomë dhe ndërsa ai tha një "mirëmbërëma" e ajo e pyeti "a u lodhe", u ulën të dy në divan.

-Babi, babi do të bëjmë dasmë, -i tha djali.

Ai qeshi.

-Po kë do të martojmë, biri i babit;që tani do nuse to?-i tha dhe qeshën të dy me Anën.

-Jo unë, jo. Beni do martohet me Lindën. Do të vemi, babi!-nxitoi t'i thoshte djali duke iu përkëdhelur te gjunjët. Ana ia tregoi ftesën dhe ai duke i përkëdhelur flokët i tha djalit

-Do të vemi, si nuk do të vemi, Të ka marrë malli për nëna Ermoinin?

-Po, po-tha djali.-E dua shumë, -dhe përplaste pëllëmbët.

Autobuzi që i çonte në dasëm, rrugës pësoi difekt dhe kur arritën ata, nusja kishte ardhur.

Teze Ermioni, sa i pa, u lëshua drejt tyre dhe duke i puthur e duke u folur për vonesën, nuk po u linte rast të sqaroheshin.

-Po më mbeti koka nga porta, mor xhan, -tha.-Përse nuk më vente mëndja, -dhe u ul e mori djalin në dorë.

-Po ty, shpirti i nënës, të ka marrë malli?-dhe e puthte djalin në sy, në faqe, në flokë e ku të mundte, duke e përkëdhelur:"Shpiti i nënës", "i vogli i nënës"e plot fjalë të tjera, që vetëm gjyshet mund t'i thonë për nipat e mbesat e tyre. Dhe ashtu, duke kuvenduar e duke u çmalluar, hynë në dhomën e pritjes. Kishte pak njerëz dhe ndërsa Tomorri, buri i tezes i prezantoi, dy vjaza të bukura filluan t'i qerasnin me lloj-lloj karamelësh, çokollatash e amaretash, siç është zakoni nëpër dasmat tona.

Ana kaloi dhe njëherë sytë mbi të pranishmit që ishin në dhomën e pritjes. Ishte vëllai i Tomorrit me të shoqen, një shok i Tomorrit, teze Figoja me burrin e vet, që e mbante veten për njeri të letrave, por që deri tani s'kishte botuar gjë, dy shokë të Benit, që me sa dukej ishin nga veriu dhe në fund në një karrige, një djalë tjetër. Kur hodhi syrin tek ai, për një çast sytë e tyre u kryqëzuan.

Ajo i hoqi sytë dhe i drejtoi te Bujari, që duhej të uronte i pari sipas zakonit.

-Gëzuar, të trashëgohet Beni dhe në dasëm të Artanit, -tha ai

-Gëzuar!-thanë të gjithë dhe ngritën gotat

-Gëzuar!-tha dhe djali në karrige.

"Po ky, -mendoj Ana, -pse foli me vete? por paska zë të bukur, -dhe ktheu prapë vështrimin andej, ndërsa djaloshi po ulte ngadalë gotën në syrinën e bufesë, ngaqë ishte disi largë tavolinës.

-Gëzuar, gëzuar, gëzuar, -tha Tomorri-dhe hë, hidhu dhe ti tani ç'pret?

Qënka i pamartuar, -mendoj Ana, -por unë ç'dreqin kam kështu?!, dhe ndjeu veten në siklet të paprovuar.

-Mua më falni, -tha -po shkoj nga Lida, -dhe u ngrit.

Djali e ndoqi me vështrimin nga mbrapa."Sikur e njoh, -mendoj, -ku ta kem parë?-Dhe zgjati dorën e mori gotën e rakisë nga bufeja.

Ana doli në oborrin e shtëpisë, që ishte i mbushur plot me lule. I donte shumë lulet teza. "Janë si njerëzit, thoshte". Po ai cili të jetë?-mendoj.-Gjëkundi nuk e kamë parë. Jo, jo. Po ç'ëndësi ka dhe ç'është gjithë ky interesim?"-tha dhe hyri në dhomën e Lidës.

Një copë herë të madhe biseduan me Lidën për tema të ndryshme ose për të gjitha temat, që mund të bisedohen në raste të tilla. Nuk e kuptoi se si fytyra e djalit iu ravijua për një çast dhe tundi kokën fort si për të hedhur lart flokët e gështenjtë dhe për të fshirë atë ravijëzim nga truri i saj. Ajo kishte 7-8 vjet që ishte martuar. Me Bujarin ishin njohur në qytetin e vogël verilindor. Ishin të dy nga jugu dhe jo vetëm ata, por shumë djem e vajza jugorë, në atë periudhë punonin, kur mbaronin shkollat, në zonat veriore e verilindore të vendit. Ai ishte një djalë i qetë e i thjeshtë, një tip studiues e punëtor. Nuk kishte ndonjë bukuri trupore që të të tërhiqte vëmendjen dhe vetë profesioni i tij nuk i linte shumë kohë për shoqëri. E donte shumë zanatin e tij. Ishte diçka më i madh nga Ana në moshë, por tiparet e fytyrës e tregonin më të madh seç ishte. Jeta bashkëshortore tregoi që mendohej të ishte një familjar i mirë për aq sa e lejonte koha që kishte në dispozicion.

Në qytetin e vogël verilindor ku jetonin, njerëzit njiheshin shpejt me njëri-tjetrin. Dhe ata ashtu u njohën. Ai i kërkoi asaj që të martoheshin në një mbrëmje të vitit të ri.

-Më pëlqen, -i tha ai thjesht.-Dhe dua të martohemi. Ajo e pa në sy për në çast. Si gjithë vajzat në moshë të saj dhe ajo kishte ëndrra për jetën. Dhe vajzat, ndryshe nga djemtë, ëndërrojnë më shumë.

-Mendohej, -tha ajo e qetë dhe u ndanë duke mbajtur i mbajtur gjatë duart njëri-tjetrit. Atë natë ajo vërtetë u mendua gjatë. Nuk kishte patur ndonjë jetë të pasur erotike, po të përjashtojmë këtu romantizmin e shkollës së mesme. Jo se ishte një vajzë e bukur si ato, që përshkruajnë poetët apo rapsodët në këngët popullore, që të lënë pa mend, që kur dalin ato nuk del hënë, por vërtet flokët ngjyrë gështenjë të derdhura mbi supë dhe dy gropëza në faqe, që krijoheshin jo vetëm kur qeshte, por edhe kur tregonte ngjarje të gëzuara me pasion, e bënin shumë të ëmbël. Tani ishte rreth tridhjetë vjeçe dhe linjat e trupit i kishte shumë të rregullta. Edhe shoqet e të njohurit patën pjesën e tyre në vendimin e saj për martesë, për fjalët e mira që i thoshnin në adresë të Bujarit e pas një viti ajo u martua e pas një viti tjetër lindi djalin.

Jeta çiftit në këto shtatë vjet martesë rridhte e qetë dhe kishte krijuar fizionominë e saj.

"Po sot ç'kam?-tha ajo me vete, -sikur diçka më goditi brenda gjirit. Po bëj sikur jam tetëmbëdhjetëvjeçare. Ej, mblidhe veten", -tha dhe e qetë u drejtua për nga Bujari, që diç bisedonte me vëllamë e Tomorrit.

Genci u tha Artanit që t'ia mbushte prapë gotën me raki.

-Ej, buçko, -i tha ai-do të të zërë dhe dasma nuk ka filluar akoma.

-Mos u bëj merak, -tha Genci dhe zgjati gotën.

Ai ishte kushëriri i largët i Tomorrit dhe punonte ekonomist në një qytet tjetër. Ishte rreth 26-27 vjeç dhe përgjithësisht ishte djalë shakatar, por edhe i bukur. Kishte patur plot aventura erotike në jetë dhe nuk nxitohej të martohej. Flokët e zezë, të ndarë në anë i binin mbi vetullën e djathtë dhe krijonin një gjysmëkurorë mbi ballin e lartë. Merrej me sport dhe hobi i tij i ishte basketbolli.

"Ku e kam parë këtë grua?- iu përsërit pyetja dhe ngriti gotën e rakisë sikur do të merrte përgjigje.-Ai vështrimi i saj sikur diçka më tha. Duket që është femër e rregullt. Mos po ia fut kot, por sikur....sikur foli m'u duk. E ç'them edhe unë. Ajo është e martuar ka dhe djalin, ka familje, i ka të gjitha. Por..sik.. rri, o Genci, "-i tha vetes dhe u ngrit e doli në oborr.

"Sa shumë lule ka ky oborr", -mendoj.

Darka e dasmës u shtrua në oborrin e madh të shtëpisë, pikërisht në atë pjesë të tij të ngarkuar me lule, të cilat të truara nga e pazakonte e mbrëmjes, sikur kishin mbledhur pak petalet të habitura. Kishte njerëz shumë jo vetëm se Tomorri kishte fis të madh e shokë shumë dhe e kishte dasmën e parë, por dhe djemtë kishin shoqëri të madhe..

Rastësia apo ku di unë çfarë e uli Gencin përballë Anës e Bujarit. Djali i vogël i erdhi në krah Anës dhe ajo u ul dhe e puthi. Gencit iu duk sikur e puthi gjatë.

Keni djalë të bukur, -i tha Genci, Bujarit.

-Është shumë çamarrok, -tha Bujari duke i përkëdhelur flokët të birit.-Ik te nënë Ermioni , tani-iu drejtua djalit.

Ana nuk foli, por ngriti vështrimin dhe pati kohë të kundronte me nge fytyrën e njeriut që kishte përballë. Kur ai ktheu sytë dhe iu përpoqën përsëri me ata të Anës, ajo i uli ngadalë.

“Ç’është kështu?”-mendoj ai.

“Ç’është kështu?”-mendoj ajo.

Dasma dalëngadalë i kishte mbështjellë të gjithë në prehërin e gazit të saj. Orkestra dhe këngët popullore në tavolina, kishin vendosur ligjin e radhës. Ana kërcente me Artanin.

Kërcimi me të e lodhi pasi ai, nga gëzimi nuk dinte ç’të bënte...Duke qeshur e rrotulluar ajo i tha me shaka:

-Avash, se nuk kamë moshën tënde unë, u plaka.

-Ua, kukulla e vëllaçkos, -i tha ai.-Po kur m’u plake ti, moj e mira e vëllaçkos?-Dhe e rrotullonte me shpejtësi. Pastaj ajo kërcu me Bujarin. Një kërcim i qetë. Mbështeti kokën në supin e tij si për të hequr vetëtimë-mendimet e saj a si për të vërtetuar që nuk i ka patur fare ato.

Kur u ulën në tavolinë, një djalosh ia mori një këngë. Vargjet e saj flisnin për një vashë-shqerkë, që bariste anës së lumit dhe zgjonte nga gjumi bandillin e saj. Në fillim kënga nuk vajti mirë dhe djaloshi, qejfli i këngës popullore, kërkoi më shumë iso. Bandilli i betohej vashës se nuk donte gjë tjetër vetëm të vinte buzën mbi gjirin e saj. Vajza e pranoi kushtin, por djali kërkonte më shumë. Atëherë vasha i kujtoi betimin që kish bërë djali:

Nga ta di kur ndizem prush

Ku ndahet gjiri me gushë

“Vërtetë, ku ndahet?” mendoi Ana. S’i kishte shkuar ndonjëherë në mend ky kufi, dhe ngriti sytë. Sytë e tjerë e prisnin.

-Unë nuk e di, -thanë

-Dhe unë, jo-u përgjigjën.

Djaloshi po e vazhdonte këngën me shumë pasion se ajo tani kishte tërhequr vëmendjen e të gjithëve dhe po vinte mirë ose siç i thonë ishte qepur dhe kur qepet kënga labe, ngre të vdekurit nga varri.

Të çlodhem , moj manushaqe,

Ku ndahet gusha me faqe

“Ku ndahet gusha me faqe, e di”, -mendoj ajo dhe vuri dorën te buza

“Dhe unë e di këtë”-mendoj ai dhe çeli pak buzën.

Përsëri ngritë sytë. Ajo me gishtin te buza, ai me buzën çelur.

“Këtë e di”-thanë

“Edhe unë, ”-u përgjigjën.

Kënga kishte mbaruar dhe orkestra filloi një tango. Genci i kërkoi leje Bujarit të kërcente me Anën dhe u ngritën. Nga tavolina e tyre e deri te vendi ku vallzohej nuk ishin larg, por të dy donin të ishte sa më larg, që të kishin kohë të mendoheshin. E megjithatë mijëra mendime u përshkruan trurin.

“Ç’bën?ku vete?pse vete?nga vete?”, ”S’e di , s’e di, por vete, vete...”

Ata zgjatën duart për vallëzim. Ai vuri lehtë dorën në mesin saj, ajo dorën e saj në supin e tij. Duart që u bashkuan sikur dridheshin me një përpëlitje të zogthëshme. Ajo afroi paksa kokën: ai ndjeu erën e flokëve të saj, ajo erën e gjirit të tij. Ai mori frymë thellë për të mos harruar aromën e flokëve, ajo mori frymë thellë për të mos harruar erën e gjirit të tij.

-Jam...

-Genci, -tha ajo

-Jam.

-Ana, -tha ai.

Dhe përsëri morën frymë thellë. Në periudhën midis frymëthellëmarrjeve, zemrat gatuanin dashurinë. E ndërsa vallëzimi kishte mbaruar, ata u nisën për në vendet e tyre. Përsëri ajo udhë. Mijëra mendime, por tani të përqendruara edhe pse habia nuk u ndahej.

Të nesërmen sytë e tyre u kryqëzuan dhe një herë tek agjencia e autobusëve, por këtë herë pak më gjatë e më me shumë të folur.

Kur erdhën në shtëpi, Ana me Bujarin ishin të lodhur. Djalin e zuri menjëherë gjumi në krevatin e tij.

-Shumë mirë u doli dasma, -tha Bujari.

-Të pëlqeu vërtet?-tha ajo dhe u zgjat e puthi në buzë, lehtë, por pak gjatë.

“Puthje e ëmbël, -mendoj ajo, -sikur po puth për herë të parë”-dhe u habit.

Ai u ngri.

-Dua të fle.-tha -nesër jam larg me punë.

-Po shtroj unë, -tha ajo, ”Po kjo, ç’ ishte?”-mërmërit me vete.

Zakonisht ai flinte më përpara se ajo dhe ritin e të shtruarit e kryente ai qëkur kishte lindur fëmija. Megjithatë u ngrit e vajti në dhomën e gjumit.

-Flij, -i tha , -unë po bëj një banjo dhe do të vij më vonë.

Dhe ashtu bëri. Hyri në banjo, hapi rubinetat dhe rregulloi ngrohtësinë e ujit. Filloi të zhvishej ngadalë deri në lakuriqësinë e saj. Ujët e ngrohtë dukej sikur e çlodhte, jo vetëm trupërisht, por edhe nga mendimet. Doli nga vaska dhe mori peshqirin para pasqyres. Duke u fshirë kundroi trupin e saj. I fshiu flokët, fytyrën, gushën dhe dora i ndaloi te gjiri. Iu kujtuan vargjet e këngës. “Ku ndahet gjiri me gushë?” dhe filloi të lozte me vete. Ndahet, nuk ndahet, ku ndahet, si ndahet...

Qeshi me vete dhe iu duk shumë e vështirë vendosja e atij kufiri. Vazhdoi të fshihej me peshqirë dhe iu ngjall dëshira për të bërë dashuri. Sa më shumë që thante ujët në lëkurën e lëmuar, aq më shumë i shtoej dëshira. Mori robdishanën, e veshi ashtu siç ishte, e lidhi një herë me rripat e mesit dhe u drejtua për në dhomën e gjumit. Hyri ngadalë në shtrat. Burrin e kishte zënë gjumi. Mbështeti kokën në bërryl dhe gjumi nuk e merrte. Rrotullohej ngadalë në shtrat sa nga njëra anë në tjetrin. Male me mendime, dete me pyetje. Asnjë përgjigje. Shkërmoqeshin mendimet, thërrmoheshin pyetjet e krahura e përzierjes së tyre, mezi e rrëmbeu në një përhumbe as të valë e as të vakët, në një kotje gjysëm zgjuar.

Si në një ekran ripërsëriti të gjithë dasmën. Truri i punonte qetë, por zemra filloi t’i rrihte shpejt. I dukej sikur kishte një zemër tjetër brenda gjirit. Vuri dorën poshtë gjirit të majtë dhe ndjeu rrahjet e saj të çritmuara. Filmi i dasmës vazhdonte she ajo ishte zhytur e gjitha në të e kur ai mbaroi, por portreti i Gencit nuk i hiqej nga mendja. Ajo u përmend si nga një ëndërr e gjatë deri në pambarim dhe e bukur deri në mosvdekje. Njëra dorë kishte mbetur te gjiri i majtë duke e shtrënguar fort atë dhe tjetra ishte shtrirë gjysmë e mbyllur në kërkim të diçkaje.

Mëngjesi kishte zbardhuar plotësisht prehrin e dheut dhe burri ishte larguar për në punë pa e prishur aspak delirin e saj.

U ngrit dhe filloi të bënte punët e shtëpisë, pastaj zgjoi djalin e veshi dhe e çoi në kopsht. Hyri në shkollë dhe gjithçka i dukej sikur kishte ndryshuar. “Çudi, -tha me vete, -si mund të ndryshojnë gjërat brenda një dite?” Gjendja i dukej sikur e afron më shumë. I dukej sikur hap më hap, çdo lëvizje, çdo veprim të saj e kontrollonte dikush dhe ai dikush donte që ta bënte mirë. Kraharori i saj ishte zgjeruar dhe të qeshurit i shpërthente edhe për një shaka të vogël.

-Moj, Ana, -i tha një shoqja e saj, pas nja dy ditësh,

-je zbukuruar shumë. Mos ke mbetur gjë shtatzënë?

-Jo, -tha ajo dhe qeshi, -as që kam ndërmend.

Nuk kishte kryer akoma marrëdhënie me burrin dhe mendoi se mos kishte ndryshuar dhe atje. Në darkë e vërtetoi që kishte ndryshuar dhe disa sekonda më prapa i pohoi vetes se kishte rënë në dashuri. Nuk pati të vështirë pohimin, ndërsa pse-në ishte e bindur që nuk do ta shpjegonte dot

kurrë. Iu bë zakon që para se të mbyllte sytë, të sillte ndërmend portretin e tij, të ndiente aromën e gjirit të tij dhe ashtu me dorën te gjiri i majtë e zinte gjumi për t'u takuar me të në ëndrra.

Genci, atë ditë që u ndanë tek agjencia, gjithë rrugës humbi në mendime. Aroma e flokëve dhe sytë e saj nuk i shqiteshin për asnjë çast. Edhe pse ishte patur të bënte me shumë femra më të reja e më të bukura se Ana, diçka e tërhiqte të mendonte për të.

Gjatë kohës, që kalonte shpejt, kudo që ishte e kujtonte me një ndjenjë të veçantë, që i shtrëngonte kraharorin, por me shpresën e humbur të takimit.

“Vetëm të ndodhë çudia, thoshte mbrëmjeve i zhytur në vetminë e tij, në apartamentin e vogël.

Dhe çudia ndodhi.

Kishte kaluar rreth një vit nga dasma, kur Anën e njoftuan për një seminar të mësuesve të ciklit të ulët në qytetin “B”

Anës i ngrinë sytë te emri i qytetit. U skuq e tëra dhe një ndjenjë përvëluese ia pushtoi trupin. Vetvetiu dora i vajti te gjiri i majtë dhe e shtrëngoi pak atë.

Ishte qyteti ku jetonte Genci.

E lexoi dhe e rilexoi njoftimin, por emri i qytetit nuk ndryshonte. Ishte pjekur dashuria brenda shpirtit të saj në netët ëndërrimtare, kur thurte e thurte skena nga më të ndryshmet, që nga ato më makabret e deri tek ato më të gëzuarat.

Filloi të përgatiste valixhen për të nesërmen. I zgjidhte gjërat me një kujdes të veçantë e pak e drithëruar, ndërsa mbrëmja po afrohej ngadalë.

Kur erdhi burri, i tha për seminarin.

-Sa ditë është?-e pyeti ai për bisedë.

-Tri ditë, -i tha ajo duke u kujdesur të mos binte aspak në sy ndjenja e brendshme që e sundonte.

Dhe ia arriti qëllimit. Zëri i doli njësoj sikur thoshte që nesër jam në punë pasdite...

Burri u drejtua për në dhomën e gjumit dhe ajo për në dush.

E bëri dushin ngadalë e me nge, nën pushtetin e ngrohtësisë së ujit dhe të mendimeve për çka do të ndodhte të nesërmen. Nuk kishte asnjë mëdyshje në vendimin e saj. Gjithçka ishte menduar e stërmunduar njëmijë herë nga turi i saj. Nga skenat e ndërtruara kur binte për të fjetur, kjo e mundësisë së takimit ndonjëherë, i kishte të parashikuara seri në detaje të gjitha. Dhe fillimin, dhe vazhdimin, dhe fundin.

E dinte ndërmarrjen ku punonte Genci she sa mbaroi seminari i paradites, se do të vazhdonte dhe pasdite, mori autobusin urban dhe kërkoi Gencin te portieri. Ai mori në telefon dhe pas pesë minutash e pa tek doli nga hyrja kryesore. Ndjeu prapë të rrahurat e forta të zemrës, ndjeu gulçin, që i vështirësoi frymëmarrjen, ndjeu prapë të nxehtit t'i ngjitej në trup dhe mollëzat e faqeve t'i digjnin. Mori frymë thellë dy-tre herë dhe u mendua të përqendrohej.

Ai në filli nuk u besoi syve. Qëndroi për në çast dhe pastaj u çapit ngadalë. I dukej vetja si në ëndërr, por sa më shumë hidhte hapa, aq më real i bëhej portreti i saj. U gjendën pranë njëri-tjetri. Kryqëzuan sytë.

-Të prisja, -thanë

-Do të vija-u përgjigjën.

Morën frymë thellë të dy, çuditërisht në të njëjtin çast, dhe buzëqeshën. Ai i futi krahun dhe u drejtuan për në park. Në atë orë parku ishte boshatisur. U ulën në stolin që dukej më i fshehtë. Ai mori duart e saj në të tija ngadalë i afroi te buza e tij. Pastaj ia la dhe vuri dorën te flokët e saj. Afroi kokën e saj te vetja dhe buzët u ngjitën. Ajo nuk kishte provuar puthje të tillë dhe ai nuk kishte njohur kurrë buzë të tilla.

Pas pak ai i tha të vinin në dhomën e tij dhe ajo me insektin e femrës vuri re padurimin e mashkullit. Buzëqeshi pak dhe iu krijuan gropëzat në faqe. Edhe ajo e donte atë, e kishte pritur, e kishte ëndërruar, e kishte dëshiruar, e kishte vendosur, por duhej të vente në seminar. Afroi buzët e saj, e puthi prapë, ashtu siç dinë të puthin vetëm femrat e dashuruara.

-Jo tani, -i pëshpëriti, -në orën shtatë mbaroj. Dot ë hyj te klubi i hotelit dhe pastaj do të ndjek nga prapa për në shtëpi.

-Dakort, -i tha ai.-Dot ë të pres atje.

U puthën përsëri dhe u ndanë.

Orët e seminarit të pasdites mezi u shtynë. Ajo e dinte seç po bënte dhe ishte e pa aftë ta frenonte veten në atë veprim edhe pse e kishte gjykuar kushedi sa herë;herë me logjikë e herë me pasion. Kur mbaroi seminari u fut në klub. Ai ishte atje. U ul në një tavolinë tjetër dhe porositi një shurup. Ia sollën shpejt, ndërsa po ndizeshin dritat e qytetit dhe bulevardi kryesor ishte mbushur plot me njerëz.

“Sa të dashuruar ka aty, -tha me vete.-Unë një...”-filloi të numëronte.

Ai hodhi vështrimin nga tavolina e saj. Kur mbaroi gotën e shurupit dhe pagoi, u ngrit doli. Ajo e ndoqi nga mbrapa.

Arriti te shtëpia e tij, hapi portën, nuk e ndezi dritën derisa ajo u fut brenda, mbylli derën me çelës dhe e rrëmbeu ne gjirin e tij. Me duart që u dridheshin e u ngatërroheshin, zhvishnin njëri-tjetrin. Ashtu në errësirë, ai e ngriti në duar dhe e shtriu në shtrat. Pas disa minutash, ai u ndrit e ndezi dritën. Ajo nuk lëvizi. Ai e vështronte. Pas pak ajo zgjati dorën, mori këmishën e tij dhe e veshi. Futi hundën te jaka e saj dhe mori frymë thellë. E njihte mirë atë aromë. Nuk do ta harronte kurrë.

Vonë e vesh me rrobat e saj për të vajtur në hotel. Në natën e tretë, kur Ana të nesërmen do të ikte i kishin thënë e i kishin bërë të tëra. Para se të ikte për në hotel, ai nisi të thoshte diçka.

-Ana, unë të dua, -i tha.-Pse duhet të eci kështu kjo punë. Ç’është për të bërë, le të bëhet.

Ajo u rrotullua ngadalë, mori kokën e tij dhe e futi te gjiri i saj, e shtrëngoi fort duke i puthur e përkëdhelur flokët. Pastaj mori dorën e tij dhe e vuri te gjiri majtë i saj. E mbajti ashtu në çast dhe kaptoi një lot, që kishte kohë që kishte mbirë në thellësinë e qënies së saj. I derdhi flokët gështenjë e të butë përpara, rrethoi fytyrën e tij me ta dhe e puthi fort, fort deri në dhembje e përtej, deri në frymëndalje e përtej.

-Duhet, -i pëshpëriti, -duhet. Vrasim shumë zemra të tjera të tjera. Dhe janë të pafajshme. Boll tonat. Dashuria nuk vret, nuk vret....

Dhe iku.

Të nesërmen ai kishte dalë tek autobusi. Ajo u ul në ndenjësën e saj dhe vështroheshin nga xhami i dritares. Vendimi ishte marrë. Kur autobusi u nis, dhe ajo nuk e shihte më, një lot i rëndë u rrokullis në faqe. Ajo nuk e fshiu as e fshehu.

Në darkë, sa hyri në shtëpi, mori djalin në duar dhe e puthte sikur kishte një jetë pa e parë.

Vinte më vonë, në një qytet të huaj, ajo e pa në urban. Edhe ai e pa. U afruan ngadalë dhe në stacionin më të afërm, zbritën.

Pyetën njëri-tjetrin. Malli dukej në sytë e tyre. Sytë nuk e fshehin mallin. Ai ishte martuar dhe kishte një vajzë.

-Duhet të jetë e bukur, -i tha ajo.

-E bukur është, -tha ai

-Ana, vazhdoj të të dua, -tha ai

-Dhe unë-i tha ajo, -por shëëëët-dhe vuri dorën te buzët.-Dashuria nuk vret, dashuria jep jetë.

-Mund të të puth ?-tha ai.

-Po -tha ajo.

Dhe u puthën përsëri deri sa cepi i syrit të saj pa autobusin që ndaloi. U shkëput nga krahët e tij dhe u fut brenda para se të mbyllej dera. Vuri dorën për në çast te xhami dhe shtypi biletën në aparat.

-U vonove, -i tha burri kur hyri në shtëpi.

-Kishte trafik, -i tha ajo duke varur çantën.

Të nesërmen ndërroi linjat e autobusëve. Ai për ditë të tëra, në të njëjtën orë, hipte në atë urban dhe zbriste tek ai stacion. Ndoshta vazhdon dhe tani me psherëtimën e Anës në vesh:”Dashuria nuk vret, nuk vret.....”